

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Dyshime për koluzion/ Ofertë nëntëshifrore me vlerë të njëjtë, si luajnë në grup Meteo dhe Ulza për të rr ethuar tenderat
ADRESA	https://piranjat.al/aktualitet/dyshime-per-koluzion-oferte-nenteshifrore-me-vlere-te-nje-jte-si-luajn-i104611
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 09:23:36 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 09:19:40 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8d873fb0392299b7e23ec9df6f39bc98d4e44abfa9153310cd48e746937631c0
TEKSTI	f06d214a517c43ef6c85863db4fb1ae5d01265cb259c730d8dacec24bf9d07be
PAMJA	bcd6ac3b2af9284fd9403db4efdfad90ead7022fb75b92602a5486efc0ecc23a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	6155c5f7cf335ef0799fdbcf7ff8f291b875a28133edd045a42314a4c0b30ee34
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	554d51ffe1583614fc44621ae1478dd51416957b577076ef62782afd72e64dbf
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/6155c5f7cf335ef0799fdbcf7ff8f291b875a28133edd045a42314a4c0b30ee34>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash:

**përgjigjet
Dhomës**

ka kthyer
përgjigje
Dhomës
si

**serioze për
sigurinë**

qeverisë
gjatë
Konferencës

**në hyrjen e
Parlamentit**

bashkë, pas
një dreke
në një nga
restorantet

patronazhistët!

**me mesazh
një ditë pas
vendimit**

djalit
Altin
Krasniq
ka marrë

AKTUALITET

Dyshime për koluzion/ Ofertë nëntëshifrore me vlerë të njëjtë, si luajnë në grup Meteo dhe Ulza për të rrethuar tenderat

Piranjat Përditësimi i fundit 17 Shtator 2026, 11:19



Një tender i Operatorit të Blerjeve të Përqendruara për mbrojtjen nga gërryerjet të Lumit Drin në Shkodër, hedh indicie të forta për koluzion në tender. Sipas dokumentave të publikuara në Agjencinë e Prokurimeve Publike, në garën me vlerë limit 2.8 milionë euro janë paraqitur 12 oferta.

OBP skualifikoi si anomalisht të ulëta tre ofertat me çmimin më të mirë dhe shpalli fitues bashkimin e kompanive Ulza dhe G.P.G.

Por tenderi zbulon një ngjarje me probabilitet statistikor të pamundur. Oferta fituese e Ulzës dhe G.P.G është e njëjtë në vlerë me atë të bashkimit të shoqërive Shëndelli dhe Meteo.

Siç tregohet nga foto të dy bashkimit e kompanive kanë ofruar çmimin 177 milionë 238 mijë e 950 lekë. Statistikisht kjo ngjarje ka një probabilitet ndodhje 1 në 243 milionë, po të merret parasysh se kompanitë kanë pasur mundësi të bëjnë oferta nga vlera 1 deri në vlerën e fondit limit, 243 milionë lekë.

Dyshimi i madh është se Ulza dhe Meteo luajnë të kordinuara për të rrethuar tenderat publikë me marrëveshje të ndaluara nga ligji i Konkurrencës.

Ky dyshim përforcohet edhe nga një fakt tjetër. Vetëm pak ditë më parë Ulza dhe Meteo ishin bashkë në joint Venture në një tjetër tender. Bëhet fjalë për rikonstrukcionin e Spitalit të Matit, një tender me vlerë 3.7 milionë euro.

Në këtë procedurë Ulza, Meteo dhe ASI-2A ofertuan së bashku në Joint Venture me vlerën 3 milionë euro, por dështuan pasi gara u fitua nga një kompani që ishte ofertë 600 mijë euro më të ulët. Megjithatë Ulza dhe Meteo po kërkojnë ta përmbysin tenderin në KPP, pavarësisht se janë 600 mijë euro më shtrenjtë se kompania e përzgjedhur fituese.

Ulza është kompania e skandalit të Unazës së Burrelit, e cila u shemb dy javë pas ndërtimit. Kjo kompani zotërohet nga një ish deputet demokristian i quajtur Ndue Shpani së bashku me vëllain e tij, Nikolin Shpani. Ulza është e fortë veçanërisht në zonën e Matit dhe mbështetet fuqishëm nga Agron Malaj.

Meteo nga ana tjetër është një kompani me bazë në Elbasan e zotëruar nga Eral Myftaraj. Dy muaj më parë, zoti Myftaraj u thir në SPAK për një tender 1 milionë euro në bashkinë e Tiranës.

Pra dy biznesmenë me rekorde jo për t'u patur zili, të cilët tashmë luajnë në grup për të rrethuar tenderat publikë.

Koluzioni në tenderat publikë është një fenomen manipulimi i pastër i tenderave me dëm të madh në kurriz të qytetarëve. Por pavarësisht kësaj, deri më tani Autoriteti i Konkurrencës nuk ka goditur asnjë rast.

Tenderi i gërryerjeve në lumin Drin është një indicie më shumë se flagrante, që Shqipëria më në fund të godasë biznesmenët të cilët bashkëpunojnë për të manipuluar tenderat publikë. / Kapitali.al

Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 17 Shtator11:05

Ndalimi i mbajtjes së celularëve në sallën e gjyqit, GJKKO i përgjigjet Dhomës së Avokatisë: Ndalimi është masë rendi dhe sigurie

Nëpërmjet një shkrese zyrtare, GJKKO i ka kthyer përgjigje Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë lidhur me k&eum...

AKTUALITET 17 Shtator10:25

Protestuesit para parlamentit: Ramoviç o tradhëtar jep dorëheqjen sa më parë

Me thirrje kundër qeverisë Rama si - "Hajduta! Qeveri e krimit! Ramoviç o tradhëtar jep dorëheqjen sa më parë!&rsqu...

Piranjat News AKTUALITET 17 Shtator10:10

VIDEO/ Arrestohet 30-vjeçari në Fier, transportonte 13 lingota e monedha floriri

Policia e Shtetit finalizoi operacionin e koduar "Gold" në Fier. Një 30-vjeçar u arrestua pasi u kap duke transportuar me automje...

AKTUALITET 17 Shtator09:58

Nis dita e 110 e revoltës! Qytetarët protestojnë pranë Kuvendit, një grup mbledhet para SPAK: Lironi çunat!

Sot është dita e 110 e protestës qytetare. Në tubimin e mbajtur ditën e djeshme para Kryeministrit është paralaj&eum...

AKTUALITET 17 Shtator09:45

Plagosi ish-vjehrrin me drapër, del para gjykatës së Fierit daja i deputetes socialiste Zegjine Çausi

Ditën e sotme do të dalë para trupës gjyquese daja i deputetes socialiste, Zegjine Çausi, Bledar Bakaj. Bakaj i cil...

AKTUALITET 17 Shtator09:30

'Vendim i rëndë ndaj ish krerëve të UÇK', Bytyçi: Pozitive që s'u njollos lufta me krime kundër njerëzimit

Për pedagogun dhe analistin Enver Bytyçi nuk ishte i pritshëm një vendim i tillë nga Gjykata Speciale e Kosovës në Hag&eu...

AKTUALITET 17 Shtator09:12

Pritet protestë para Parlamentit, policia bllokoi zonën me gardh metalik

Kuvendi zhvillon sot seancën plenare, ndërsa paralelisht jashtë ambienteve të Parlamentit është paralajmëruar edhe një...

AKTUALITET 17 Shtator09:08

Operacion antidrogë në Korçë, arrestohen 3 të rinj, sekuestrohen rreth 6 kg kanabis

Finalizohet një operacion antidrogë në Korçë, në kuadër të të cilit janë arrestuar tre persona dhe jan&eum...

Piranjat News AKTUALITET 17 Shtator08:49

Shqiptarët protestojnë në Times Square kundër dënimeve të Hagës për ish-udhëheqësit e UÇK-së: Liri për çlirimtarët tanë!

Dhjetëra shqiptarë që jetojnë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dolën në protestë në sheshin e njohur ...

AKTUALITET 17 Shtator08:41

Tre të rinj të plagosur me thikë në Sarandë, njëri dërgohet në Tiranë, në pranga 2 persona

Tre të rinj janë plagosur me thikë mbrëmjen e së mërkurës në Sarandë, ndërsa policia ka arrestuar dy persona...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 16 Shtator

Sarandë, tre persona plagosen me thikë pranë sh...

Një ngjarje e rëndë është shënuar mbrëmjen e sotme në Sarandë, ku tre persona kanë mbetur të plagosur me ...

BOTA 16 Shtator

VIDEO- Dy aksidente me pesë viktima/ Prezantues...

Pesë persona kanë humbur jetën në një aksident të dyfishtë tragjik në Los Anxhelos, ndërsa një gazetarë televi...

KOSOVA 16 Shtator

[Kush është Charles Smith, gjyqtari që dënoi me...](#)

Charles L. Smith III është gjyqtari amerikan që kryesoi trupin gjykues në çështjen ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, R...

INVESTIGIME 31 Maj14:01


[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video




E premte | ? 20:45 | ???? Syri TV







E premtë | ? 20:45 | ??? Syri TV



Çdo të premtë | ? 20:45 | ??? Syri TV





Si u tentua të shantazhohei me 100 mië euro shefi i kabinetit të Përdarim Ramës përmes mediave

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.